



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
ZYRA E ÇËSHTJEVE SOCIALE  
KESHILILI

**MBI FONDIN E KUSHTEZUAR PER BLOK NDIHMEN EKONOMIKE DERI NE 6%  
RELACION**

Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 57/2019, date 18.07.2019. "Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar, Kreu IV, pika 2 te Vendimit Nr.955, date 07.12.2016, te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e kriterëve, te procedurave, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te ndihmes ekonomike" te ndryshuar, Vendim Nr.5, date 23.02.2018 "Mbi miratimin e kriterëve per familjet ne nevoje, me perjashtim te pikes 1,6,7.

**Te shtohen ne bllok-ndihmen e 6% familjet;**

1. Dava Mhill Marku – Grua e vetmuar, pa asnje te ardhur dhe me probleme shendetore



**Te largohet nga bllok-ndihma prej 6%**

1. Katrine Prendi – per mungese fondi

Pergjegjese e Ceshtjeve Sociale  
Fitnete ARIFAJ

Kryetari  
HIL CURRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
ZYRA E ÇËSHTJEVE SOCIALE  
KESHILILI

Projekt-Vendim

Nr. 2336 Prot

Fushë-Arrez, më 22.10.2024

**MBI FONDIN E KUSHTEZUAR PER BLOK NDIHMEN EKONOMIKE DERI NE 6%**  
Ne mbështetje të ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019. "Per Asistencen Sociale ne Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar, Kreu IV, pika 2 të Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Keshillit të Ministrave "Per përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së perfitimit të ndihmes ekonomike" të ndryshuar, Vendim Nr.5, datë 23.02.2018 "Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, me përjashtim të pikës 1,6,7, që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmes ekonomike.

Propozojme :

Te trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2024, **34 familje**, me fond **136,979** leke nga fondi total i ndihmes ekonomike në vlerën **2,282,993** leke dhe shpërndare për perfituesit e 6% në Shumen **135,286** leke sipas Njesive:

Bashkia Qender Fushe-Arrez **16** familje me fond **55,730** leke

Njesia Administrative Iballe **6** familje me fond **25,028** leke


Njesia Administrative Qafe-Mali **6** familje me fond **29,760** leke

Njesia Administrative Fierze **2** familje me fond **6,752** leke

Njesia Administrative Blerim **4** familje me fond **18,016** leke

**Përgjegjëse e Çështjeve Sociale**

**Fitnete ARIFAJ**



Adresa: Fushë-Arrëz, Prefektura Shkodër, email: info@bashkiafushearrez.gov.al

**Kryetari**

**Hil CURRI**



REPubliKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa: Fushë-Arrëz, sheshi kryesor i qytetit, Tel: 027123131, mob: 0692078875, email: bashkiafushearrez.gov.al

Nr. 2150, Prot

Datë 10/07/2024

P/VENDIM

Nr. 21, datë 10/07/2024

PËR  
MIRATIMIN E FAZËS SË PARË TË BUXHETIT AFAT MËSËM 2025-  
2027

Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij te datës se mësipërme, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri", Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni "41, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 25, neni 26, neni 27 dhe neni 28, Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, neni 34, neni 35, neni 36, neni 37, neni 38 dhe neni 39, Udhëzimit nr. 23, datë 22/11/2016 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit Vjetor nr. 3, datë 28/02/2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", pas diskutimit nga Këshilltarë të pranishëm:

VENDOSI:

1. Të miratojë fazën e parë të buxhetit afat mesëm 2025-2027, sipas materialit shkresor bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet të gjithë sektorët pranë Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe Inspektori për informimin publik.
3. Ky vendim u shpall me datë \_\_\_/\_\_\_/2024 dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

PARAQITËN PROJKETIN:

PËRGJEGJËSI I FINANCËS

Dritan LIKA

KRYETARI

Hil GURRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI

Nr.2222/Prot

Fushë-Arrëz më, 09 / 07 / 2024

P/VENDIM

Nr.20 datë 09.07.2024

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE “KRYEZI”  
NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ”

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni nr.11, pika 2, germa b; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”; VKM-në nr.361, datë 12.05.2010 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik”; Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019”, si dhe Shkreses Nr.18 datë 26.06.2024 “Dërgohet drafti i Planit të Mbarështimit të ekonomise pyjore “Kryezi, “Fushë-Arrëz”:

- I propozojmë Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz miratimin Planit të Mbarështimit të ekonomise pyjore “Kryezi” për vijimin e procedurave për miratimin e tij nga Ministria e Mjedisit dhe Turizimit sipas Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni nr.11, pika 2, germa b.
- Bashkëlidhur këtij Projekt – Vendimi është relacioni shprehës për hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomise pyjore “Kryezi”.

DREJTORI I ADM PYJEVE DHE KULLOTAVE

Ardmir Doda

KRYETARI

Hil Curri



JURISTI

Redona Hasani

KRYETARI I KESHILLIT

Nikolin Bardhoku

Gjithsesi, kërkohet një edukim i vazhdueshëm dhe menaxhim afatgjatë e i qëndrueshëm për ti vënë në funksion të përmiresimit të cilësisë së jetesës për komunitetet dhe grupet e interesit në zone.

Problematika kryesore në zone ka të bëjë me migrimin dhe emigrimin e brezit të ri, burime të kufizuara financiare për familjet, si dhe menaxhimi jo i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Detyrat kryesore për 10 vjeçarën e ardhshme në zbatim të këtij Planit Mbarështimi rrjedhin nga programi strategjik i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit pyjeve e kullotave në harmoni të plotë me programet e Bashkisë Fushe Arrez.

## 1. HYRJE

### 1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjorë.

Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar "*sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve*". Gjithashtu, ky plan mbarështimi duhet të garantojë përdorim racional të burimeve natyrore pyjore dhe kullimore, si dhe të kontribuojë në cilësinë e jetesës në zonën rurale.

Objektivat e projektit të ri janë prezantuar tek të gjithë aktorët, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore.

**Objektivat e planit të mbarështimit u hartuan në mbështetje të ligjit për zhvillimin e sektorit pyjorë, ligji kuadër 57/2020 "Për pyjet" dhe në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për pyjet në Bashki, popullatën dhe organet e pushtetit vendor. Objektivat kryesore janë:**

- Sigurimi i normalitetit në grumbujt pyjorë, që të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një përdorim racional duke siguruar prodhim maksimal nga grumbujt pyjor.
- Vlerësimi i pyllit si ekosistem multifunksional për ruajtjen e biodiversitetit dhe shtimit të të ardhurave në dobi të popullatës lokale.
- Intesifikimi i rritjes natyrore të grumbujve duke kryer ndërhyrjet e domosdoshme silvikulturore dhe duke vjelë në mënyrë racionale materialin drusor nga grumbujt pyjorë.
- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i ripërtëritjes natyrore nëpërmjet kryerjes së punimeve për sigurimin e gjeneratës së re të pyjeve në ato pjesë të territorit ku ajo mungon ose është dëmtuar.
- Përmirësimi përbërës llojor, duke stimuluar përzierjet fletorë +halorë.
- Rritje e cilësisë së kërcellit dhe e kurorës së drurëve me synim përmirësimin e cilësisë e prodhimit të grumbujve.
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe rritja e sipërfaqes së grumbujve pyjorë të mirëshërbyer prej saj, mirëmbajtja dhe shtrirja optimale e rrjetit rrugor.
- Përpjekja maksimale për kontrollin e erozionit dhe mbrojtjen e burimeve ujore.
- Pakësimi i ndikimit negativ në gjendjen shëndetsore të pyjeve dhe ndalimi i veprimtarive të paligjësme në territorin pyjor dhe kullor.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA FUSHE-ARREZ  
KESHILLI

Nr 2366 prot.

Fushe-Arrez, më 24.07.2024

P/VENDIM

*Nr 22. D. 24.07.2024*

PER MITRATIMIN E PLANIT TE INTEGRITETIT TE BASHKISE FUSHE-ARREZ  
PER PERIUDHEN 2025-2027.

Ne zbatim e ligjit 13/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar ,neni 1,germat "c", "d",  
"e", "m" nenit 9, 13,15, 16, 17, 18, 19, 21,33, 43, 47, 52, 54, Keshilli i Bashkise Fushe-Arrez ne  
mbledhjen e tij te dates 29. 07.2024 , pasi u njoh me Planin e Integritetit te paraqitur nga grupi i  
punes "IDM", pas diskutimeve

VENDOSI :

Te miratoje Planin e Integritetit te Bashkise Fushe-Arrez per periudhen 2025-2027 te pergatitur  
nga grupi i punes IDM sipas materialit bashkelidhur ketij projekti.

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkise Fushe-Arrez.

Paraqiten projektin :

PERGJEGJESJA E SEKTORIT TE BURIMEVE NJEREZORE

KRYETARI

Fatona SELIMAJ

Hil CURRI



MIRATOI

KRYETARI

Nikolin BARDHOKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. 2366/Pref.



Fushë-Arrëz, më 24/07/2024

## RELACION

### Mbi Planin e Integritetit

Duke qenë se Bashkitë qeverisin më pranë qytetarëve e si rrjedhojë kontaktet ndërmjet zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe publikut janë më të shpeshta, duke rritur kështu dhe mundësitë për shfaqjen e risqeve të tilla si raste të shfaqjes së konfliktit të interesit, nxjerrje e një informacioni konfidencial apo privat, diskriminimin, etj. Bashkia Fushë-Arrëz ka ndermarrë nismën për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027 me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e risqeve të Integritetit si dhe hartimin e një plani masash për minimizimin e tyre në një plan afatmesëm. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kalon në disa faza , të cilat janë:

- Përgatitja , komunikimi dhe mobilizimi i Burimeve Njerëzore
- Identifikimi dhe analizimi i risqeve të Integritetit
- Vlerësimi i risqeve të Integritetit
- Plani i masave për menaxhimin e Integritetit

Të gjitha këto janë të shpjguara në Planin e Integritetit i cili është i hartuar nga bashkëpunimi i Ministrisë së Brendshme me pushtetin vendor që financohet nga Bashkimi Evropian , Qeveria e Suedisë, Qeveria e Zvicres, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, UNDP në Shqipëri dhe Qeveria e Shqipërisë.

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!*

Përgjegjësia e Sektorit të Burimeve Njerëzore

Fatona Selimaj

vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin e një plani masash për minimizimin e tyre në një plan afatmesëm.

### **1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz**

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kaloi nëpërmjet vlerësimit të fushave të veprimtarisë administrative dhe fushave të funksioneve kryesore që Bashkia gëzon sipas ligjit. Më konkretisht, gjatë procesit u vlerësua: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe e mekanizmave kundër korrupsionit që përfshin edhe zbatimin e legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit dhe vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve e të informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike.

Vlerësimi u zhvillua nga një Grup Punë i ngritur nga Kryetari i Bashkisë ku bënë pjesë përfaqësues të administratës së bashkisë nën drejtimin e ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim gjatë periudhës mars-qershor 2024.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kaloi në fazat e mëposhtme:

#### ***Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore***

Plani i Integritetit është në thelb një instrument vetëvlerësimi nga stafi i bashkisë dhe një strategji masash të cilat konsiderohen të realizueshme, ndaj hapi i parë i procesit të hartimit të planit të integritetit konsiston në ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga administrata dhe nga nëpunës të fushave kryesore të funksioneve të bashkisë. Grupi i punës u prezantua me Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me hapat e punës si dhe u trajnuua mbi çështjet e integritetit dhe etikës në administratën publike. Së fundi, në këtë fazë u bë komunikimi i qëllimit dhe objektivave të Planit të Integritetit me administratën e bashkisë, nga ana e Grupit të Punës.

#### ***Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit***

Grupi i punës shqyrtoi kornizën rregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë. Me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore, në këtë fazë u zhvilluan 7 grupe të fokusuara me punonjësit e bashkisë sipas fushave të kompetencave të përgjithshme dhe funksionale. Në këtë fazë, punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit.

#### ***Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit***